



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:194239

Datë: 28.12.2023

Numri i dokumentit: 05229466

PPP.nr.851/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fatbardha Uka Ibrahimimi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit KRM “P.” Sh.a, me seli në Prishtinë, kundër debitorit L.P., nga P., rr., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit B.T. avokat nga Prishtina, lidhur me çështjen përmbartimore, për shkak të borxhit në shumën prej 252.00 €, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër urdhrimit përmbartimor P.nr.539/20, të datës 09.10.2020, të lejuar nga përmbartuesi privat Emine Sherifi - Lubeniqi, për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET prapësimi i debitorit L.P., nga P. dhe **SHFUQIZOHET** urdhri përmbartimor P.nr.539/20, i datës 09.10.2020, lejuar nga përmbartuesi privat Emine Sherifi - Lubeniqi, për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

A r s y e t i m

Përmbartuesi privat, Emine Sherifi – Lubeniqi ti si organ përmbartues, sipas propozimit të kreditorit KRM “P.” ka lëshuar urdhërin përmbartimor P.nr.539/20 të datës 09.10.2020, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste për periudhën kohore nga viti 01.01.2009 deri më 31.07.2013, në shumë prej 252.00 €, me të cilin ka kërkuar që debitori të obligohet që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrimit t’i paguaj kreditorit borxhin me kamatë prej 8% nga dita e lejimit të përmbartimit e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër urdhërit përmbartimor P.nr.539/20 të datës 09.10.2020, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim përfaqësuesi i autorizuar i debitorit, me ç’rast ka theksuar se në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se fatura e fundit në mes debitorit dhe kreditorit ka qenë me datë 31.07.2013 dhe që nga atëherë nuk kanë pasur obligime ndaj njëri tjetrit. Ka shtuar se, që nga

momenti i faturimit të fundit, kanë kaluar më shumë se 8 vite, andaj sipas ligjeve në fuqi, përkatësisht Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve, shihet qartë se plotësohen kushtet e parashkrimit sipas nenit 360 të LMD-së. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe anulohet urdhri përmbarimor P.nr. 539/20 i datës 09.10.2020.

Kreditore në përgjigje në prapësim ka theksuar se thirrja në parashkrimin e kërkeses për këtë borxh nuk do duhej të zinte vend në këtë kundërshtim. Kjo duke u bazuar në kartelën financiare të debitorit shihet qartë që debitorit ka kryer pagesa të kohë pas kohshme të kësteve mujore gjë që ka ndikuar që instituti i parashkrimit të ndërpritet. I ka propozuar gjykatës që Urdhëri për përmbarim të mbetet në fuqi dhe propozimi të përmbarohet, ndërsa kundërshtimet e debitorit të refuzohen të pabazuara.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, nga këto arsye:

Sipas ekstraktit nga librat afarist, gjykata gjeti se është kërkuar për periudhën nga data 01.01.2009 deri më datë 31.07.2013, në shumën totale prej 252.00 €, ndërsa propozimi për përmbarim lidhur me borxhin e lartcekur është paraqitur më datë 09.10.2020, i lejuar me urdhërin përmbarimor Nr. 539/20 të datës 09.10.2020.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e nenit 378 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare nr.29/78), e cila ka qenë në fuqi për periudhën e krijimit të të borxhit nga data 01.01.2009 deri më datë 19.12.2012. Kurse periudha pas datës 19.12.2012 e deri në arritjen e borxhit të fundit për pagesë, përkatësisht më datë 31.07.2013, mbulohet me nenin 360 par. 1 të Ligjit Nr. 04/L077 të Marrëdhënieve të Detyrimeve, sipas së cilit parashihet se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një viti: (1.1.) kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*, ndërsa sipas paragrafit 2 të njëjtit nen është përcaktuar: *“afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”*, andaj rrjedhimisht kreditore e ka humbur të drejtën për të kërkuar realizimin me detyrim të kërkesës së arritur për pagesë, dhe se i njëjti nuk ka ofruar asnjë dokument-dëshmi që do të ndikonte që gjykata të vendos ndryshe nga ajo që ka vendosur në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Sipas nenit 43 par. 4 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, përcaktohet se: *“Përmbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*.

Gjykata, analizozi pretendimet e kreditorit, mirëpo te njëjta nuk kishin rëndësi vendimtare në vendosjen ndryshe sipas dispozitivit të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, prandaj shfuqizoj urdhrin përmbarimor.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr.851/21, datë 28.12.2023

Gj y q t a r j a
Fatbardha Uka Ibrahim

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në kopje të mjaftueshme.